



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:189595

Datë: 18.10.2023

Numri i dokumentit: 04796827

**PKR.nr.200/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** në përbërje të turpit gjykues nga gjyqtarja Violeta Husaj Rugova, kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Sami Sharaxhiu dhe Shaqë Curri anëtar të turpit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj në lëndën penale ndaj të akuzuarve: Sh.Gj. nga S. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së, dhe V.H. nga fshati B., K. P. për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së, pas mbajtës së shqyrtimit gjyqësor publik në seancat e me data 14.06.2023, 19.09.2023 në praninë e Prokurores së Shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarës Sh.Gj. dhe mbrojtëses së e saj sipas detyrës zyrtare av. Shqiponjë Beqiraj, të akuzuarit V.H. dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare av. Shëndrit Muriqi, më datë 19.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.10.2023 përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**SH.GJ.**, e lindur me datë ..... në S., e bija e R. dhe e nënës N. e gjinisë P., ka të kryer shkollën fillore, e divorcuar, nënë e .. fëmijëve, e pa punë, e gjendjes mesatare ekonomike e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**V.H.**, i lindur me datë ..... në P., me banim në f. B., K. P., i biri i Xh. dhe i nënës H. e gjinisë N., ka të kryer shkollën fillore, i divorcuar, baba i .. fëmijëve, me profesion berber, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim sipas një lënde tjetër.

**JANË FAJTOR**

**E akuzuara Sh. Gj.**

**Për shkak se:**

-Me datë 16.05.2022, rreth orës 13:22:23 në Q. K. në D. K. I., e pandehura pa autorizim posedon me qëllim të shpërndarjes substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotik (Ligji nr.02/L-128) narkotik të llojit “Marihuanë” në peshë prej 2.7 gram brenda I. K. të sipërshënuar, në atë mënyrë që, ditën kritike e pandehura kishte shkuar për të vizituar të pandehurin V., i cili ishte në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale, ku në pjesën e brendshme të rrobave të saj (të organet gjenitale) kishte futur substancën narkotike bashkë me tabletat “Tramadol” në peshë prej 6.63

gram të sipërshënuar, të cilën më pas e nxjerrë dhe ia lëshon në duar të pandehurit, ku oficerët korrektues me të vërejtur ndërhyjnë dhe e sekuestrojnë substancën narkotike, e cila pas ekzaminimit ka rezultuar me peshë dhe e llojit si më lartë,

-Me çka ka kryer vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 nën par.1.8 të KPRK-së.

**I akuzuari V.H.  
Për shkak se:**

-Me datë 16.05.2022, rreth orës 13:22:23 në Q. K. në D. K. I., posedon substancë narkotike të llojit “Marihuanë” në peshë prej 2.7 gram të cilat janë shpallur me ligj si narkotik (Ligji nr. 02/L-128), në atë mënyrë që, ditën kritike nga e pandehura Sh. (bashkëshortja e tij) gjatë vizitës në qendrën si më lartë merr substancën e përshkruar si më lartë, me ç’rast me tu vërejtur nga ana e zyrtarëve korrektues, ndërpritet vizita, ku të pandehurin V. e vendosin në një dhomë të veçantë për ta kontrolluar dhe i njëjti hedhë në dysHEME qesen me substancë narkotike dhe tableta të llojit “Tramadol” në peshë prej 6.63 gram.

-Me çka ka kryer vepër penale “Posedimi i pa autorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par. 1.8 i KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 6,7,38,42,43,69,70, të KPRK-së, nenit 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 nën par.1.8 të KPRK-së, neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par. 1.8 i KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i

**G J Y K O N**

**Të akuzuarës Sh.Gj.**

I caktohet dënim me burg në kohe zgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro). Të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në çiftë se e akuzuara Sh.Gj. nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës.

E akuzuara obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumen prej 50 € (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë)ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Të akuzuarit V.H.**

I caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënimi me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro). Të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në çoftë se i akuzuari V.H. nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar si më lartë, atëherë dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë prej 2.7 gram, si dhe tabletat e llojit “Tramadol” në peshë neto të përgjithshme 6.63+0.0001 gram konfiskohen dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të asgjësohen.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.176/2022, të datës 17.10.2022 ndaj të akuzuarve: Sh.Gj. nga S. për shkak se ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së dhe V. H. nga f. B., K. P. për shkak se ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin i ka njoftuar të akuzuarit lidhur me të drejtat e tyre konform nenit 323 të KPPK-së. Të akuzuarit kanë deklaruar se i kanë kuptuar të drejtat e tyre dhe kanë kuptuar edhe aktakuzën. E lidhur me fajësinë e akuzuarit Sh.Gj. ka deklaruar se e pranon që ka dërguar substancën narkotike të akuzuarit V., mirëpo ka qenë e detyruar. Ndërsa i akuzuari V.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë sa i përket tramadollit, ndërsa substanca narkotike ka ardhur pa dijen e tij në atë qese. Duke pas parasysh deklaratimet e të akuzuarve gjykata ka konstatuar se të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë. Pastaj ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me procedurën e provave.

### *Provat e administruara*

Gjykata ka administruar provat siç janë:

- raporti ndaj vizitorit të lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 16.05.2022.
- raporti i oficerit T. K. me nr. #.... i dt. 16.05.2022.
- raporti informues me numër ref ../-./.../.... i dt. 17.05.2022.
- deklarata e bashkësisë familjare me numër serik F ..... i datës 03.08.2018.
- raporti i analizës së narkotikëve “N. T.” e datës 16.05.2022.
- vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm i sendeve i datës 16.05.2022.
- lista e dëshmive e datës 19.05.2022
- raporti i ekspertimit me numër referues .../...-.../...-....., i datës 28.07.2022.
- parashpresa e Q. K. e D. e dt. 16.05.2022 ku është përshkruar transmetimi i mjeteve përkatësisht i provave të zyrtari i DHTN-së.

- fotodokumentacioni në shkresat e lëndës i dt. 16.05.2022.
- deklarata e të pandehurës Sh.Gj. e dhënë në polici me datë 16.05.2022.
- deklarata e e të pandehurit V.H. e dhënë në prokurori me datë 19.09.2022
- deklarata e të pandehurit V.H. e dhënë pranë Q. K. D. me datë 25.05.2022 dhe
- deklarata e të pandehurës Sh.Gj. e dhënë pranë prokurorisë me datë 19.09.2022.
- është shikuar Video incizimi në CD i ditës kritike.
- parashtresa për tërheqjen e padisë me nr. C.nr.137/20223 e datës 20.04.20232 si dhe
- dy deklarata të datës 29.08.2022 të dhëna nga Sh.Gj. dhe F. H. në Q. për M. e g..
- deklarata e dhënë në polici të Sh.Gj. në cilësi të dëmtuarës me datë 07.07.2022.

### *Mbrojtja e të akuzuarve*

E akuzuara *Sh.Gj.* në mbrojtjen e saj të dhënë par gjykatës me datë 14.06.2023 ka deklaruar se mbrojtën do ta jep në heshtje.

E akuzuara *Sh.Gj.* në deklaratën e saj të dhënë në polici me datë 16.05.2022 në cilësi të dyshuarës kishte deklaruar se para një jave kishte folur nga numri fiks edhe përmes Facebookut me burrin e saj *V.*, ai i ka thënë me shku me u taku me një djalë të *P.* i cili ka pas me i jep *Marihuanë*, edhe ky sipas *V.* e ka një person brenda, pas insistimeve të *V.* dhe kërcënimeve të tij e ka lënë me taku në *P.* në magjistrale ku pritet autobusi, aty ka ardh një *G.* . ngjyrë hiri dhe ia ka jep barin dhe e njëjta ka vazhduar për *P.* me fëmijët e saj, pastaj më vonë është kthyer në shtëpi. *Marihuanën* ka vendos me ia dërgu veç mos mi ndodh gjë e keqe vëllezërve të saj, pasi ai e kërcënonte se do t'ju bënte keq vëllezërve e sidomos pasi që dy vëllezër iu kishin vlarë në luftë. *Bashkëshorti* i saj më parë ka qenë përdorues i substancave narkotike, kurse tani i thotë se nuk e përdorë. Ditën kritike përveç *marihuanës* i ka dërgu edhe hapa *Tramadol* dhe certifikatën e bashkësisë familjare, këto hapa i ka marr në barnatore në *I.* tek rruga që shkon te stacioni i autobusëve, aty i ka ble nga 1.9 euro pa receipt. *Vjehrra* ia kishte dhënë të hollat me shku në *D.*, mirëpo ajo nuk e ka ditë se çka është duke qar në *D.*, ajo e ka ditë që ka kërcënime nga *V.*, por për atë ditë nuk e ka ditur. Nuk e ka lajmëruar policin se ka qenë e kërcënuar nga *V.* ngase ka menduar se ai do të përmirësohet hatri i fëmijëve. Por, ai prapë ka vazhduar me kërcënime, e njëjta ka deklaruar se ndihet e penduar është nënë e dy fëmijëve dhe nuk ka të ardhura tjera përveç ndihmës sociale në vlerë prej 120 eurove, shkak që e ka shty është kërcënimi që iu ka bërë që disa vite.

Në deklaratën e saj të dhënë në prokurori me datë 19.09.2022 e akuzuara *Sh.Gj.* ka deklaruar se substancën narkotike ia ka siguruar një shok i *V.* të cilin nuk e njeh me emër dhe mbiemër, ndërsa tabletat *Tramadol* i kishte blerë vetë personalisht në një barnatore në *I.* pa asnjë recetë, ditën kritike kontrollin e ka kaluar pa problem sepse substancën dhe tabletat i ka pasur të vendosura në organet gjentiale. Pasi që ka hyrë në sallë të vizitave ku ka qenë *V.* përball ulur në një tavolinë, i ka nxjerr sendet si më lartë dhe ia ka dhënë në dorë mbi tavolinë dhe në atë moment kanë reaguar gardianët duke e marr *V.* e duke e dërguar ndaras nga ajo. *V.* është konsumues i substancës narkotike edhe një herë i ka dërguar substancë narkotike para katër viteve ku i është zënë nga ana e personave të *QKD-së* dhe është dënuar nga ana e *Gjykatës*. Kishte vepruar në këtë mënyrë për shkak të kërcënimeve që i janë bërë nga ana e *V.* Është penduar dhe është nënë e dy fëmijëve për të cilët përkujdeset dhe ka qenë në njëfarë mënyre e detyruar të veprojnë nga frika se mos po ju ndodh diçka fëmijëve dhe asaj, e familjarëve të saj, tani është larguar nga shtëpia e *V.* për shkak të frikës dhe banon në një vend që nuk don ta tregoj.

I akuzuari *V.H.* në mbrojtjen e tij të dhënë para gjykatës me datë 14.06.2023 ka deklaruar se ditën kritike ka pasur vizitë, dy-tri ditë më herët ka pasur kontakt telefoni përmes skype i ka kërkuar të akuzuarës *Sh.* që ti sjell tableta *Tramadoll*, për shkak se në spitalin e *D.* në atë kohë

ka pasur mungesë dhe ka pasur nevojë shumë për to, i ka kërkuar që e akuzuara Sh. ti merr edhe fëmijët në vizitë. Përgjigja e saj ka qenë se vajza është në shkollë ndërsa djali është i sëmurë. Ditën kritike ka hyrë në sallë siç është parë edhe në video incizim, pasi që është përshëndetur e ka pranuar qesen me tramadol dhe nuk e ka ditur që mundet me u shkaktua vepër penale, kur kanë ardhur oficerët e akuzuara i është drejtuar merr veprën përsipër nëse don mi pa fëmijët, kur është qu prej tavoline dhe ka dashtë me e kthy kësen për shkak se nuk ka vepër penale për tramadol pse me marr veprën përsipër, kanë hy gardianët dhe e kanë shti në dhomë për bastisje, qesen e kanë gjetur në tokë për shkak se ka ra në tokë kur është desh. Nuk e ka ditur se aty ka marihuanë për shkak se e kanë qu menjëherë në vetmi. Me datë 17.05.2022 kur ka ardhur komisioni hetimor me marr në pyetje aty e ka kuptuar se ka pasur edhe një sasi të narkotikut-marihuanë, dhe pasi që ka menduar për fëmijët aty e ka kuptuar se çfarë i ka thënë dhe aty është deklaruar se është fajtor po ashtu edhe në polici. Kjo vepër e ka pengu të dal nga burgu për vikend dhe e akuzuara Sh. ka dashur ose ka pasur frikë nga ky, ashtu që ka dashur deri sa është brenda ky, ajo ta stabilizoj jetën e vet. Sikur të kishte qenë e kërcënuar siç thotë ajo nuk kishte pasur mundësi të shkoj në deti dhe të ia le fëmijët motrës së vet në një motel ku fëmijët kanë përjetuar ankth dhe frikë. Është trajtuar për narkotik ka qenë dy herë në forenzik. Në vuajtje të dënimit është që nga data 04.10.2018, me Sh. Gj. është në bashkësi familjare që nga viti 2012 dhe i kanë dy fëmijë. Ajo çka ka deklaruar në polici me datë 25.05.2022 në faqen e 3 është e vërtetë dhe ka deklaruar ashtu sepse ka qenë i kushtëzuar me fëmijët dhe nuk e ka ditur qysh mu deklarua ndryshe. Në vitin 2017 e akuzuara Sh.Gj. i ka sjell substancë narkotike kur ka qenë për herë të parë në burg dhe ka qenë përdorues i narkotikut, ndërsa tani është për herë të dytë në burg dhe tani nuk është përdorues i narkotikut. Në polici ka qenë i detyruar për të deklaruar se është përdorues i substancave narkotike që 7 vite i të gjitha llojeve.

I akuzuari V.H. në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 29.09.2022, përveç të tjerave aty ka deklaruar se nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë pranë Qendrës Korrektuese në D., K. I. me datë 25.05.2022 për faktin se ka qenë në presion dhe i kushtëzuar dhe ka deklaruar jo të vërtetën. Qe katër vite është në vuajtje të dënimit Q.K. në D., gjatë këtyre viteve bashkëshortja e tij ka qenë në vizite edhe gjatë vitit 2017 e pandehura Sh. ka tentuar dhe është zënë me substancë narkotike, kësaj here e akuzuara Sh. kishte sjellë substancë narkotike pa kërkesën e tij, ndërsa 60 tableta të llojit Tramadol i ka sjell me kërkesën e tij. Me të akuzuarën Sh. kishte biseduar përmes Skype dhe përmes telefonit që gjendet në kabinat e QKD-së, ka bërë porosi për tabletat, disa rroba, gjësende të tjera si dhe t'ia sjell fëmijët. Me të shkuar në sallë të vizitave është ulur në tavolinë përball Sh.s dhe menjëherë e njëjta ka marr një qese e cila për të ka qenë me Tramadolla, sapo i ka marr kanë ndërhy zyrtarët korrektues dhe në ato momente Sh. i ka thënë merre për sipër këtë vepër nëse don mi pa fëmijët ndonjëherë. Nuk është e vërtetë që e ka kërcënuar në ndonjë mënyrë të akuzuarën Sh. apo familjarët e saj.

Me rastin e dhënies së deklaratës para hetuesve në Q. K. në D. me dt.25.05.2022 i njëjti kishte në mënyrë të njëjtë kishte përshkruar se si e kishte pranuar substancën narkotike dhe tabletat Tramadol. Pastaj thekson : “unë kam kontaktuar dhe e kam organizuar çdo gjë por që për çështje të sigurisë nuk mund të tregoj, pra për çështje të sigurisë personale.... Nga askush dhe as që ka pasur as ndihmë nga brenda. Pastaj i njëjti thekson .....se kishte biseduar me Sh. nëpërmes kabinës ndoshta diku një muaj më përpara nuk i kujtohet nëse atyre u ka dhënë snapchatin e saj apo numrin e saj, ata kanë kontaktuar me të dhe i kanë dërguar marihuanen asaj për të cilën nuk ka paguar asgjë por i kanë dhënë në mënyrë shoqërore.....Gjatë bisedës me Sh. i ka thënë duke i bërë presion me fjalët ose ma sjellë narkotikun ose merri fëmijët dhe shko te familja e jote dhe ndoshta edhe e kam shajtë atë pasi që isha në krizë shëndetësor si shkak i mungesës së narkotikëve.....Substancën narkotike e konsumon që 7 vite dhe i merr të gjitha llojet..... Sh.

është zënë edhe një herë njëjtë dhe edhe atëherë e kam detyruar unë duke i bërë presion. dhe i kishte kërkuar substancën...

### *Fjala përfundimtare*

*Prokurorja* e shtetit në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim theksuar se: nga raporti ndaj vizitorit të lëshuar nga Sh. K. i K. me datë 16.05.2022, nga zyrtari B.Xh. dhe B. Z., nga i cili vërtetohet se ditën kritike zyrtarët në fjalë kanë vërejtur nga kamerat se vizitorja-e akuzuara Sh. ka nxjerrë diçka nga rrobat dhe i ka dhënë te dënuarit V.H., ku menjëherë te njëjtit kanë hyrë në sallë dhe e kanë tërheq te dënuarin për ta dërguar në një dhomë te veçantë për bastisje dhe i njëjti posa janë futur në këtë dhomë ka nxjerrë nga xhepi i majtë një qese te cilën e ka hudh poshtë në dyshe dhe pas hapjes se qeses kanë dal te jenë 60 tableta te dyshuara Trodon dhe një substancë e dyshuar narkotike 5 gram. Andaj, nga ky raport vërtetohet se te njëjtit paraprakisht kanë pasur dijeni dhe marrëveshje për sjelljen e substancës narkotike në QKD, andaj nuk qëndron pretendimi i te akuzuarit V.H. se i njëjti është vu në lajthim dhe nuk ka qenë në dijeni për substancën narkotike, përndryshe veprimi i ndërmarrë nga ana e tij për hedhjen e qeses vërteton te kundërtën e asaj qe deklaroi.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 16.05.2022, rezulton se ditën kritike i janë sekuestruar: substanca e dyshuar narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë bruto prej 5.6gr. dhe 60 kapsula, ngjyrë të verdhë me të gjelbër, të dyshuara si hapa “Tramadol”. Raporti i analizës së narkotikëve “NarTest” me nr. rasti ....-....-... i datës 16.05.2022, nga i cili vërtetohet se, nga dëshmia e evidentuar si D#1 sipas analizës së bërë me NarTest ....., ka rezultuar si pozitiv dhe është cilësuar si substancë narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë neto prej 2.7 gram. Raporti i ekspertimit me nr. referues: .../....-..../....-.... i datës 28.07.2022, nga i cili vërtetohet se, dëshmitë # 1.1, #1.2, #1.3, #1.4, #1.5, #1.6, #1.7 dhe #1.8, nuk përmbajnë asnjë narkotikë të rrezikshëm, substancë psikotrope apo prekursorë, pesha neto e përgjithshme:  $6.63 \pm 0.0001$  gram ku përmbajnë “Tramadol”. Nga “CD”-ja e siguruar nga vendi i ngjarjes, gjegjësisht nga kamerat e sigurisë të vendosura në Q.K. në D., e cila në shqyrtimin gjyqësorë te datës 14.06.2023, është realizuar video shiqimi i te njëjtave, ku është konstatuar në faqe 6 te procesverbalit te shqyrtimit gjyqësorë si dhe janë përshkruar veprimet dhe lëvizjet që janë bërë nga ana e te akuzuarve, e të cilat fuqishëm provojnë se te njëjtit janë penalisht përgjegjës për veprimet qe i kanë ndërmarrë ditën kritike. Nga deklarata e bashkësisë familjare me numër serik F ....., i datës 03.08.2018, vërtetohet se te akuzuarit kanë qenë në bashkësi familjare dhe te njëjtit janë prindër te dy fëmijëve, andaj nga kjo rrjedh që te njëjtit kanë pasur një marrëveshje në mes vete për veprimet që i kanë ndërmarrë me datë 16.05.2022.

Nga mbrojtja e të akuzuarës Sh.Gj. e dhënë në prokurori me datë 19.09.2022, (te cilës i referohemi meqenëse e njëjta gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e saj ka shfrytëzuar te drejtën për tu mbrojtur në heshtje), ndër te tjera ka deklaruar: *“substancën narkotike ma ka siguruar një shok i V. te cilin nuk e njoh me emër e mbiemër, por i njëjti ma ka sjellë afër shtëpisë, gjithnjë sipas porosisë se V., pasi që ky i fundit më ka informuar se i njëjti ka për ta sjellë këtë substancë”*.

Nga mbrojtja e te akuzuarit V.H. e dhënë në gjykatë me datë 14.06.2023, i njëjti e ka mohuar te këtë pasur dijeni se ka pasur sasi te narkotikut dhe se kinse këtë e ka kuptuar kur ka ardhur komisioni hetimor për me marrë në pyetje si dhe ka shtuar se e akuzuara Sh. ka dashur ose pasur frikë nga unë që deri sa te jem unë brenda ta stabilizojë jetën e vet. Kjo deklaratë e te njëjtit është në kundërshtim me deklaratat te cilat i ka dhënë me parë dhe atë me deklaratën e dhënë në Q. me datë 25.05.2022, ku në prezencën e mbrojtësit te caktuar sipas detyrës zyrtare e ka pohuar se

i njëjti e ka bërë porosinë e substancës narkotike dhe i ka bërë presion te akuzuarës Sh. qe ta sjellë narkotikun, andaj kjo është deklarata e parë që është dhënë menjëherë pas rastit në fjalë andaj edhe është me e besueshmja.

Konform të lartcekurave dhe provave të administruara konsideron se në tërësi është vërtetuar se te akuzuarit, secili veç e veç janë penalisht përgjegjës për veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj kërkojë nga ana e gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtor, ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, po ashtu Gjykatës i propozoj që me rastin e matjes së dënimit si rrethana rënduese konform nenit 70 te KPRK-së, të merr për bazë: Shkallën e lartë te dashjes, E kaluara kriminale e të akuzuarve.

Më tutje prokurorja në fjalën përfundimtare të saj përshkruan aktgjykimet në bazë të të cilave të akuzuarit kanë qenë të gjykuar dhe thekson se nga aktgjykimet gjen se i akuzuari V.H. është recidivist i shumëfishtë i veprave penale, edhe përkundër që i njëjti është dënuar nga viti 2013 deri në vitin 2018 dhe ka qenë në vuajtje të dënimit për veprat penale për të cilat edhe është dënuar, i njëjti asnjëherë nuk është përmirësuar, me çka dënimet e shqiptuara nga gjykata nuk kanë arritur qëllimin e dënimit në raport me të njëjtin, andaj i propozoj Gjykatës që të aplikoj premisat e përcaktimit të dënimit sipas Udhëzimit të Politikave Ndëshkimore të Gjykatës Supreme vitit 2018, i cili parasheh pikënisjen e matjes së dënimit.

Mbrojtësja e të akuzuarit *V.H. av. Shëndrit Muriqi Berisha* ne fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka thksuar se: duke u bazuar në provat e administruara në shqyrtim kryesor dhe në atë që kanë dëgjuar konsideron me bindje se nuk është argumentuar teza e aktakuzës publike e veprës penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i saj V.H.. I mbrojturi i saj qysh nga fillimi i procedurës e ka pranuar faktin se i njëjti ka kërkuar nga bashkëshortja e tij tableta të ashtuquajtura “Tramadol”, të cilat ka qenë duke i përdorur edhe në Q. K. me recetë nga mjekët e Q. K. dhe këtë kërkesë e ka bërë pasi që në atë kohë në Q. K. ka pasur mungesë të tabletave konkrete. I njëjti këtë kërkesë e ka bërë duke qenë në dijeni se këto tableta janë të lejueshme për përdorim dhe se nuk përmbajnë substancë narkotike që do e bënte përdorimin e tyre të kundërligjshëm faktin se këto tableta nuk janë substancë narkotike e argumenton edhe Raporti i ekspertimit me nr.Ref. .../...-.../...-... i dt. 28.07.2022 me të cilin vërtetohet se tabletat “Tramadol” të cilat i ka pranuar i mbrojturi i saj nuk përmbajnë asnjë narkotik të rrezikshëm, substancë psikotrope apo prekursorë), Duke u bazuar në këtë fakti i mbrojturi i saj nuk e ka ditur e as nuk ka mundur të dijë se po që se i porosit këto tableta në peshën të cilën i ka pranuar është vepër penale e kundërligjshme, prandaj i njëjti ka qenë në lajthim juridik lidhur e pranimin e tabletave “Tramadol”, bazuar në nenin 26 të KPRK-së, ndërsa sa i përket pranimit të substancës narkotike sikur në aktakuzë i mbrojturi i saj të njëjtën nuk e ka porositur dhe nuk e ka ditur se e pandehura tjetër ia ka futur në të njëjtën qese me tramadolët e kërkuar. Pra i mbrojturi i saj duke e pranuar qesen të cilën ia ka ofruar bashkëshortja e tij dhe duke menduar se ka vetëm Tramadol in e kërkuar ka menduar se gjendet në rrethana krejtësisht të lejuara dhe prandaj e ka pranuar. Andaj i njëjti e ka kryer veprimin duke qenë në lajthim faktik lidhur me veprimet e tij bazuar në dispozitën e nenit 25 par.1 të KPK-së. Prokurorja e shtetit me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i mbrojturi i saj e ka kërkuar substancën narkotike, është i varur nga narkotikët, apo e ka kërcënuar të pandehurën Sh.Gj. siç ajo pretendon. Madje nga të gjitha provat e paraqitura në shkresat e lëndës që janë të pa diskutueshme dhe nga vetë fakti se e pandehura tjetër Sh.Gj. gjatë gjithë procedurës ka vërtetuar se nuk është person i përgjegjshëm, i ka ikur urdhrin të gjykatës për tu paraqitur në procedurë dhe me provat tjera janë argumentuar deklaramet e të mbrojturit të saj se pa dashjen e tij dhe me qëllimin e përgatitur të të pandehurës tjetër është gjendur në situatën e cila sot e ngarkon me këtë vepër penale. Në prezencën e këtyre rrethanave dhe të një ser rrethanave tjera të natyrës lehtësuese që u janë njohura dhe që do ti vlerësoni padyshim, lutem

që të mos orientoheni kah vepra, por të orientoheni kah kryesi, po deshët që dënimi të mos jetë hakmarrje, të mos jetë shpagim, të mos jetë retribucion, të mos jetë qëllimi i vetvetes, po të matet në proporcion me nevojën e riedukimit dhe risocializimit të kryesit. Është e sigurt se në personalitetin e tij, pra në cilësitë dhe veçorit shpirtërore të këtij personi vërehet dukshëm përmirësimi i tij dhe fokusimi i tij në një të ardhme të pastër, prandaj është i bindur se me dënim fare të butë do të arrihet qëllimi i dënimit i përcaktuar me ligj.

I akuzuari *V.H.* në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtës së tij dhe nuk ka diçka për të shtuar.

Mbrojtësja e të akuzuarës *Sh. Gj. av. Shqiponjë Beqiraj* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar se pas mbajtës së shqyrtimit gjyqësor në të cilin janë administruar provat materiale të propozuara nga prokurori në aktakuzë, provat e propozuara nga mbrojtja, si dhe pas paraqitjes së mbrojtës nga njëri prej të akuzuarve është vërtetuar se e mbrojtura e saj ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par. 1.8 të KPRK-së për çka në fillim të kësaj procedure është deklaruar fajtores dhe penalisht përgjegjëse këtë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale si në polici, prokurori ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas aktakuzës PP/I.nr.176/2022 të datës 17.10.2022 të Prokurorisë Themelore në Pejë e mbrojtura e saj akuzohet se veprën penale e ka kryer brenda institucionit korrektues, ajo shpreh keqardhje për veprën e kryer, mirëpo veprimet e saj kanë ardhur si pasojë e presioneve dhe kërcënimeve të vazhdueshme nga ana e bashkëshortit të saj këtu të akuzuarit *V.H.* Kjo është vërtetuar edhe nga Procesverbali i Policisë së Kosovës Stacioni në Pejë, me numër të rastit ....-...-... i datës 07.07.2022 ku së bashku me të mbrojturën e saj e kanë paraqitur rastin në polici. Nga ky procesverbal është vërtetuar se i akuzuari *V.* sa herë që ka kontaktuar me të mbrojturën e saj përmes telefonit nga *Q. K. në D.* apo kur ajo ka shkuar për vizitë tek ai, e ka kanosur se do ta gjej ndonjë e keqe atë apo familjen e saj nëse ajo nuk vepron sipas udhëzimeve të tij. Kërkesa konkrete e të akuzuarit *V.H.* ka qenë se e mbrojtura e saj *Sh.Gj.* ti dërgoj substanca narkotike atij. Prandaj duke pas parasysh rrethanat e lartcekura kërkon nga Gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh edhe këto rrethana lehtësuese siç është pranimi i fajësisë, pendimin e sinqertë për veprën e kryer, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, faktin se është nënë e dy fëmijëve, gjendjen e rëndë ekonomike dhe të vetmin burim financiar në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur asistencën sociale. Mbi këtë bazë propozon që Gjykata në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 69 neni 72 e veçanërisht neni 71 të KPRK-së të mbrojturës së saj ti shqiptoj një dënim nën minimumin e posaçëm, ngase konsideron se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

E akuzuara *Sh.Gj.* në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtës së saj dhe nuk ka diçka për të shtuar.

\* \* \*

Gjykata gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të aktakuzës dhe pretendimeve të prokurorisë, mbrojtjes së të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, si dhe të provat materiale, të cilat i ka vlerësuar veç e veç dhe në ndërlidhje logjike dhe faktike me njëra tjetrën, u vërtetua se e akuzuara *Sh.Gj.* tani me banim në *S.* është fajtores për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së, dhe *V.H.* nga fshati *B.*, Komuna Pejë është fajtorë për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së.



### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor për të akuzuarit vërtetoi se :

- I akuzuari V.H. me të akuzuarën Sh. ishte në bashkësi familjare dhe me të kishte .. fëmijë të përbashkët . dhe . vjeçar ( në kohën kur po zhvillohej gjykimi), i njëjti gjendej në burgun e Dubravë në vuajtje të dënimit për vepra të ndryshme penale.

-I akuzuari V. kishte biseduar në Skype dhe në telefon në kabinat e Q. K. D. me të akuzuarën Sh. dhe kishte kërkuar nga e njëjta që kur shkon në vizitë ti sjell substancë narkotike Marihuan dhe tableta Tramadol.

--Me 16.05.2022 rreth orës 13.17 e akuzuara Sh. hyn në sall ku kishte shkuar për vizitë tek i akuzuari V. dhe gjatë vizitës diku rreth orës 13:22.23 ia dorëzon një qese, dhe me tu vërejtur nga gardianët e burgut, të cilët e kishin nën përcjellje vizitën pasi që kishin dyshuar në të akuzuarën Sh., ndërhyjnë në sallën e vizitave ndërpejn vizitën marrin të akuzuarin V. për ta dërguar në dhomë të veçantë për kontroll, i akuzuari V. e hedhë në dysheme qesen në të cilën ishte substanca narkotike.

-Zyrtarët korrektues pasi marrin qesen kontrollojnë të njëjtën dhe ka rezultuar se ishte substancë narkotike dhe tableta Tramadol.

-Substanca narkotike ishte matur ashtu siç ishte e mbështjell kishte rezultuar 5.6 gram dhe ishin 60 tableta tramadol. Mirëpo pas matjes së serishme dhe ekzaminimit kishte rezultuar me 2.7 gram substancë narkotike e llojit Marihuanë dhe 60 tableta tramadoll me peshë prej 6.63 gram.

### *Fakte të pa kontestuara*

Koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale nuk u kontestua dhe nuk u kontestua fakti se e akuzuara Sh. i kishte dërguar substancën narkotike dhe tabletat e llojit Tramadol ditën kritike në Q. K. në D. dhe ia kishte dhënë të akuzuarit V..

### *Fakte të kontestuara*

Që të dy të akuzuarit kontestuan kryerjen e veprës penale?

E akuzuara Sh. me pretendimin se ka qenë e kërcënuar nga i akuzuari dhe ka qenë e detyruara të ia dërgoj substancën narkotike sipas kërkesës së tij.

I akuzuari V. me pretendimin se nuk ka kërkuar substancë narkotike të akuzuarës por se e akuzuara Sh. ia kishte bërë qëllimisht.

### *Provat që vërtetuan gjendjen faktike*

Siç u cek më lartë nga të akuzuarit nuk kontestuan kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, mirëpo gjykata zyrtarisht me vlerësimin e provave e veçanërisht nga shikimi i video incizimit vërtetoi se vepra penale është kryer me datë 16.05.2022, rreth orës 13.22.23 në Q.K. në D. K. I., e jo ashtu siç është thënë në aktakuzë rreth orës 15:00.

-Nga raporti ndaj vizitorit të lëshuar nga Sh. K. i K. me dt 16.05.2022 vërtetohet se me dt.16.05.2022 e akuzuara Sh.Gj. kishte shkuar për vizitë në B. e D. për të dënuarin V.H. dhe se e njëjta ishte kontrolluar nga zyrtarja korrektuese B. B. dhe e njëjta i kishte njoftuar se për kundër bastisjes vizitorja Sh. ishte e dyshimtë nëse ka të fshehur diçka në organet gjenitale. Nga udhëheqësi i ndërrimit ishin urdhëruar zyrtaret korrektues B. Xh. dhe B. Z. që ta përcjellin vizitën e V.H., e kishin përcjellë me kamerë dhe posa ka filluar vizita rreth orës 13.20 është vërejtur nga kamerat se vizitorja e lartcekur po nxjerr diçka nga rrobat dhe ja jep të dënuarit V.H., kanë hyrë menjëherë në sallë e kanë tërhequr të dënuarin V.H. dhe kanë dërguar në një dhomë të veçantë për bastisje. Sapo janë futur brenda zyrtaret B. Xh. dhe B. Z. i dënuari ka nxjerr nga gjepi i majtë një qese të cilën e ka hudhë poshtë në dysheme. Pas hapjes së qeses kanë qenë 60 tableta të dyshuara trodon dhe substancë e dyshuar narkotike rreth 5 gram.

-Nga raporti i oficerit T. K. me nr.....-.....-.... vërtetohet se me datë 16.05.2022, kishin pranuar rastin nga Q. K. D. bashkë me raportet e oficerëve në lidhje me të burgosurin V.H. ku dhe kishin filluar veprimet për zbulimin e kësaj çështje.

-Nga deklaratat e bashkësisë familjare me numër serik F ..... i datës 03.08.2018 vërtetohet se të njëjtit kishin bashkësi familjare dhe kishin dy fëmijë të moshës së mitur një . vjeç dhe një . vjeç.

-Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër rasti ....-.....-.... të datës 16.05.2022 janë sekuestruar 5.6 gram bruto substancë e dyshuar narkotike e llojit “Marihuanë” dhe 60 kapsula ngjyrë të verdhë me të gjelbër, të dyshuara si tableta Tramadol.

-Nga parashtrësia parashtrësia e Q. K. të D. e dt. 16.05.2022 ku është përshkruar transmetimi i mjeteve përkatësisht i provave të zyrtari i D.-së vërtetohet se substanca e dyshuar narkotike dhe tabletat e dyshuara janë transferuar nga zyrtari korrektues A. A. të zyrtari policorë T. K., si dhe CD me incizime nga zyrtari Korrektues departamenti i sigurimit A. A. të zyrtari policorë R. P..

-Nga raporti informues me numër ref ../-../.../.... i dt. 17.05.2022 vërtetohet se janë ndërmarrë veprimet hetimore pasi që kanë pranuar rastin nga Q. K. në D. dhe se kanë kërkuar që të dërgohet në agjensionin e Kosovës për Frenzikë për 60 tabletave në form të kapsulave.

-Nga lista e dëshmimeve e datës 19.05.2022 rezulton se substanca narkotike e llojit marihuan më peshë bruto 5.6 gram me dt.16.05.2022 e sekuestruar në Q. K. D. është vendosur në zingjirin e ruajtjes dhe ka numër të dëshmisë D#.

-Nga raporti i analizës së narkotikëve “Nar Test” e datës 16.05.2022 rezulton se substancës së dyshuar narkotike nga dëshmia D#. i është bërë matja dhe analiza me pajisjen Nar Test ..... me numër serik ..... e cila pajisje e kryen analizën në mënyrë automatike dhe ka rezultuar se është substancë e narkotike e llojit marihuan në peshë prej 2.7 gram.

-Nga raporti i ekspertimit i Agjensis së Kosovës për Forenzikë me numër referues .../....-...../.....-....., i datës 28.07.2022, vërtetohet se dëshmitë #...., #...., ....., ....., ....., ....., ....., nuk përmbajnë substancë narkotike të rrezikshme, substancë psikotrope apo prekursorë. Të njëjtat përmbajnë Tramadol dhe pesha e tyre e përgjithshme është 6.63 gram.

-Nga fotodokumentacioni në shkresat e lëndës i dt. 16.05.2022 shifet substanca narkotike e konfiskuar dhe tabletat. Nga fotografit vërtetohet se substanca narkotike ishte e mbështjellë me fole të aluminit e njëjta ishte matur ashtu siç ishte dhe kishte rezultuar në peshë prej 5.6 gram

(foto matja në peshore), ishte matur pasi që i ishte larguar folja dhe vetëm substancë narkotike kishte rezultuar 2.7 gram, si dhe 60 tableta- kapsula me ngjyrë të verdhë me të gjelbër Tramadol.

-Nga video incizimi në CD e datës 16.05.2022, vërtetohet se incizimi ishte në sallën e vizitave ku të akuzuarit ishin ulur dhe aty shifet e akuzuara kur rreth orës (12:17), ndërsa koha reale ishte 13:17 nga se sipas sqarimeve në kallëzim penal dhe raportit lidhur me video incizime konstatohet se ora në kamerat e sigurisë nga ku edhe ishte nxjerrë video incizimi ishte një orë pas, shihen lëvizjet e të akuzuarës Sh. kur rreth orës 13:22: 23 e akuzuara Sh. lëviz me duar në drejtim të rrobave të veta pantallonave dhe pastaj vendos duart mbi tavolinë dhe ndër letër të cilën e posedonte i akuzuari V. në dorë ia jep diçka të dyshuarit- bashkëshortit të saj, gjë që vërehet nga oficerët korrektues- gardianet të cilët e ndërprejnë vizitën dhe të akuzuarin V. e largojnë nga salla e vizitave dhe e dërgojnë për kontroll dhe pastaj edhe të akuzuarën Sh..

*Provat që kanë të bëjnë me rrethanat familjare por që nuk ishin relevante për gjendjen faktike*

-Gjykata e vlerësoj parashtrësën për tërheqjen e padisë me nr. C.nr.137/20223 e datës 20.04.2023 si dhe dy deklaratat të datës 29.08.2022 të nënshkruara nga Sh.Gj. dhe F. H. në Q. për M. e g., të njëjtat kanë të bëjnë me atë që e akuzuara Sh.Gj. kishte hequr dorë nga besimi i fëmijëve në Q. për M. e g. – shtëpia e sigurt në P. dhe se vjehrra e të akuzuarës Sh.Gj. njëkohësisht nëna e të akuzuarit V.H. kishte marrë përsipër me vullnetin e saj se do të kujdesej për fëmijët dhe se Sh. mund ti kontaktoj kur ka nevoj, nga parashtrësja për tërheqje të padisë rezultoi se e akuzuara Sh. Gj. kishte tërhequr padinë me dëshirë pasi që kishte krijuar jetë të re bashkëshortore dhe nuk është më e interesuar që fëmijët e saj K. dhe K. H. ti besohen asaj. Pra këto prova gjykata i vlerësoj si jo relevante për gjendjen faktike pasi që nuk vërtetojnë asgjë lidhur me veprat penale që u vihen në barrë të akuzuarve, përveç një heqje dorë në mënyrë vullnetare e të akuzuarës Sh.Gj. nga kujdesi i fëmijëve të saj.

*Deklarata që gjykata nuk e mori për bazë*

-Deklarata e dhënë në polici të Sh.Gj. në cilësi të dëmtuarës me datë 07.07.2022 gjykata rezultoi se e njëjta pas kishte futë substancën narkotike në B. e D. për bashkëshortin e saj dhe ishte zënë nga oficerët korrektues, pas dy kishte shkuar në polici dhe kishte lajmëruar rastin kinse ka qenë e kanosur, ku në mes tjerash kishte deklaruar: “i akuzuari V. vazhdimisht e kishte kërcënuar me fjalët “Të vras familjen, të vras ty dhe fëmijët” për shkak se donte që e njëjta të fuste drogë në Burg për V.. Hera e fundit që e kishte vizituar V. ka qenë me datë 16.05.2022, ku i kishte dërguar drogë V. dhe ishte nxënë nga ana e policisë. Pasi që e njëjta është ndier e kërcënuar është larguar nga shtëpia e bashkëshortit, dhe ishte vendosur në f. I. tek motra e saj dhe ve ndodhjen nuk e din as V. e as familjaret e tij andaj gjykata këtë deklaratë të saj nuk e mori për bazë pasi që është bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale kinse veprimet e saj i ka ndërmarrë pasi ka qenë e kanosur nga i akuzuari V. dhe kjo deklaratë ishte dhënë diku për afërsisht dy muaj pas rastit që kishte ndodhur. Ndërsa nuk i kundërshton fare provat- deklaratat ku shënon se me dëshirë ia kishte dhënë fëmijët vjehrrës së saj për mbikëqyrje dhe këto deklarata ishin nënshkruar nga e akuzuara dhe vjehrra e saj. Po ashtu kishte tërhequr nëpërmjet mbrojtëses së saj padinë për besimin e fëmijëve ku shënon se me vullnet kishte hequr dorë nga padia për besimin e fëmijëve për shkak se kishte krijuar jetë të re.

*Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve*

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarve secilit veç e veç.

E akuzuara Sh.Gj. para gjykatës është mbrojtur në heshtje, ndërsa ka dhënë deklaratë në polici me datë 16.05.2022 dhe në prokurori me datë 19.09.2022.

E akuzuara Sh. para gjykatës është mbrojtur në heshtje, mirëpo e njëjta në fillim të shqyrtimit gjyqësorë me rastin e deklaramit për fajësinë nuk ka mohuar se e ka dërguar substancën narkotike ashtu siç është përshkruar në aktakuzë, por është deklaruar e pafajshme me pretendimin se ka qenë e detyruar nga V., ndërsa mbrojtësja e saj në fjalën hyrëse thotë se e akuzuara i kishte dërguar substancën narkotike të akuzuarit V., pasi ai i ka thënë se nëse nuk i dërgon marihuanen nuk do ti shoh fëmijët. Në deklaratën e dhënë në polici me dt. 16.05.2022 e njëjta e pranon se kishte kontaktuar me të akuzuarin V. nëpërmes telefonit fiks dhe nëpërmjet të facebook, ku i njëjti i kishte kërkuar substancë narkotike dhe e kishte njoftuar se një djalë nga Prizreni do të ia sjell, mirëpo e njëjta thotë se V. e kishte kërcënuar se do të ju bënte keq vëllezërve të saj. Ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori lidhur me kërcënimin thekson se: se ka vepruar në këtë mënyrë për shkak të kërcënimeve që i janë bërë nga ana e V. në drejtim të saj dhe familjarëve të saj dhe se kërcënimet kanë vazhduar edhe pas këtij rasti dhe e ka lajmëruar rastin në polici.

Marrë parasysh kundërthëniet e të njëjtës lidhur me kërcënimet që i ka bërë i akuzuari V., kur herë thotë e ka kërcëruar për vëllezërit, e pastaj atë dhe fëmijët, faktin se i akuzuari V. gjendej në i mbyllur në Burg në vuajtje të dënimit, janë dëshmi të mjaftueshme që mbrojtjes së të akuzuarës Sh.Gj. të mos i falet besimi. E kësaj duhet shtuar faktin se e njëjta në parashtresë ku ka tërhequr padinë thekson se: “ka krijuar jetë të re” dhe i ka lënë edhe fëmijët në mbikëqyrje të gjyshes së tyre- nënës së V. dhe këtë e kishte bërë me vullnetin e saj, *veprime këto që i merr përderisa i akuzuari V. është në vuajtje të dënimit*. Nëse e njëjta do të ishte e kërcënuar dhe do të ndihej e frikësuar nga i akuzuari V. kishte mundësi të lajmërimit të rastit, ashtu siç ka bërë dy muaj pas rastit. Prandaj të gjitha pretendimet se veprimet e saj i kishte marrë nga se ishte detyruar gjykata i vlerësoj si të pa bazuara.

I akuzuari V. ka dhënë mbrojtjen para gjykatës, pranë hetuesve policorë në Q. K. D. me datë 25.05.2022 dhe pranë prokurorisë me datë 19.09.2022.

I akuzuari V. si në mbrojtjen e tij të dhënë para gjykatës, në polici dhe në prokurori e kishte pranuar se nga e akuzuara Sh. ditën kritike kishte pranuar substancën narkotike dhe tabletat tramadol.

I akuzuari V. në deklaratën e dhënë në polici kishte deklaruar se nëpërmjet telefonit të kabinës i kishte kërkuar të akuzuarës Sh. që të ia sjell substancën narkotike, vetë e kishte kërkuar dhe organizuar nuk ka qenë i shtytur nga askush, madje thekson se edhe i kishte bërë presion nga se ishte në krizë shëndetësore si pasoj e mungesës së narkotikut, ku dhe thekson se i ka përdorur të gjitha llojet e substancave narkotike.

Në mbrojtjen e dhënë para gjykatës në deklaratën e dhënë në prokurori deklaroi pothuajse në mënyrë të ngjashme duke mohuar veprën dhe mohon të ketë kërcënuar të akuzuarën Sh., mohon ti ketë thënë të njëjtës për t'ia sjell substancën narkotike, duke theksuar se ajo e ka bërë këtë nga se ky ka pas me dal për vikend ndërsa Sh. ka dashur që sa është ky në burg ta rregulloj jetën e vet.

Marrë parasysh mbrojtjen e të akuzuarit V. e cila ishte në kundërthënie me deklaratën e tij të dhënë në polici, fakti se ishte përdorues i substancës narkotike dhe hedhja e substancës në dysHEME kur është marrë nga zyrtarët e burgut- gardianët për kontroll e veçanërisht nga mënyra e komunikimit gjatë vizitës që kishte me të akuzuarën siç shifet në video incizim, vërtetohet se

i njëjti e kishte ditur se e akuzuara Sh. i kishte sjellë substancën narkotike sipas kërkesës së tij dhe substancën narkotike e kishte pranuar dhe e kishte në posedim, andaj edhe pretendimet e tij për mos dijeninë janë të pa bazuara.

Gjykata e vlerësoj mbrojtën e të akuzuarve në raport me njëri tjetrin ku të njëjtit në tentim që ta shfajësoj veten i vënë fajit njëri tjetrit, mirëpo mbrojtën e tyre e vlerësoj si të pa bazuar dhe të bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, andaj edhe nuk ua fali besimin.

### *Vlerësimi ligjorë*

1. Vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, parasheh që:

-Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca ose preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

2. Vepra penale Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.1 të KPRK-së, parasheh që:

-Kushdo që pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope apo analoge dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet .

-Neni 275 par.1 dhe nën par.1.8 i KPRK-së parasheh që dënimi për raste të rënda të veprave penale të parapara me nenet 267, 268, 269, 270 ose 272 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim në mes e disa pikave, pika 1.8. parasheh: *nëse vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.* Pra kjo dispozitë parashehë dënim më të lartë kur bëhet fjalë për institucionin korrektues dhe inkorporon në vete të dy veprat penale të cekura më lartë.

Gjykata ka analizuar elementet e këtyre veprave penale të cekur si më lartë në raport me provat e administruara dhe faktet e vërtetuara dhe ka gjetur se: në veprimet e të akuzuarës për Sh.Gj. janë plotësuar elementet e veprës penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së”, ndërsa në veprimet e të akuzuarit V.H. janë plotësuar elementet e veprës penale “posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 dhe nën par.1.8 të KPRK-së”.

Gjatë shqyrtimit u vërtetua se të akuzuarit veprat penale që u vihen në barrë i kanë kryer në I. K.. Të njëjtit kishin një bisede paraprake në telefon dhe skype, ku i akuzuari V. e kishte porositur të akuzuarën Sh. që ti sjellte substancë narkotike, të cilën do të ia sjellte një person dhe tableta Tramadoll. Ku e akuzuara Sh. substancën narkotike të llojit marihuan e kishte siguruar nga personi tek i cili e kishte porositur i akuzuari V., pastaj arrin ta fusë në qendrën korrektuese në D. dhe pasi që ishin takuar në dhomën e vizitave në Q. K. në D. e njëjta ia kishte dhënë substancën bashkë me 60 tableta tramadoll të akuzuarit V.. Pra u vërtetua se akuzuara Sh. substancën narkotike e kishte siguruar dhe poseduar dhe e kishte shpërndarë, ngase arrin të ia dorëzoj të akuzuarit V.. Ndërsa i akuzuari e kishte marrë në posedim dhe e kishte për vete.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se tek të akuzuarit secilit veç e veç ka ekzistuar dashja, dijenia e po ashtu edhe vullneti që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit për secilin veç e veç, pasi që të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tyre dhe e kanë dëshiruar kryerjen e veprave. E këtë e provon edhe fakti se edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra të njëjta penale të kryera brenda I. K..

Në Gjykatë gjatë tërë procedurës penale nuk është paraqitur asnjë rrethanë e cila do të përjashtonte apo do të zvogëlonte përgjegjësinë penale të të akuzuarve për çka gjykata vlerësoj se të njëjtit janë personalisht përgjegjës.

#### *Rrethanat për dënimin*

Gjatë përcaktimit të dënimit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat relevante që ndikuan në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe nenit 70 të KPRK-së.

Nga rrethanat lehtësuese për secilin të akuzuar veç e veç mori parasysht gjendjen e dobët ekonomike dhe faktin se kanë dy fëmijë të përbashkët, rrethana të tjera lehtësuese nuk gjeti.

Nga rrethana rënduese për të akuzuarit gjykata i mori për bazë sjelljen e tyre të mëparshme ku që dy të akuzuarit ishin persona të dënuar edhe më parë për vepra penale të njëjta, ndërsa i akuzuari V.H. edhe për vepra penale të ndryshme. I akuzuari V.H. ishte i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda P.nr.79/17 të datës 22.12.2017 i formës së prerë me datë 04.01.2018, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm P.nr.255/15 të datës 28.05.2015 i formës së prerë me datë 02.06.2015, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm P.nr.91/14 të datës 05.01.2017 i formës së prerë me datë 11.01.2017, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm P.nr.109/18 të datës 05.03.2018 i formës së prerë me datë 06.03.2018, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm P.nr.480/17 të datës 22.03.2018, i formës së prerë me datë 04.04.2018, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda P.nr.84/2018 të datës 26.11.2018, me aktgjykimin Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda P.nr.139/2014 të datës 12.01.2015. Ndërsa e akuzuara Sh.Gj. ishte e dënuar me aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda P.nr.53/2017 të datës 04.09.2017 dhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda P.nr. 79/17 të datës 22.12.2017 i formës së prerë me datë 04.01.2018.

Me rastin e vlerësimit të këtyre rrethanave dhe matjes së dënimit të shqiptuar, gjykata ka përcaktuar dënimet e shqiptuara si në dispozitiv me bindjen se me këto dënime do të arrihet qëllimin i ndëshkimit dhe i konsideron adekuate me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera e në përpjesëtim të drejt me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve. Gjykata konsideron se do të ndikoi pozitivisht në ndërgjegjësimin e tyre në të ardhmen si në drejtimin e preventivës individuale dhe të asaj gjenerale, si qëllimi i këtij dënimi në kuptim të dispozitës së nenit 38 të KPRK-së.

#### *Vendimi mbi konfiskimin*

Vendimi mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi u morë në bazë nenit 267 par. 5, 269 par.3 dhe 275 par 2 të KPRK-së.

#### *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës*

Vendimi mbi shpenzimet e gjyqësore dhe paushallin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është marrë konform nenit 449 dhe 450 të KPPR të Kosovës.

*Vendimi për kompensimin e viktimat*

Vendimi mbi taksen për kompensimin e viktimave të krimit si në sipozitiv të këtij aktgjykimi u mor konform nenit 39 par.1,2,3 nen par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj nga sa u tha më lartë e në bazë të dispozitave të lartcituara ligjore dhe konform nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,  
2022:189595, 18.10.2023**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.